



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P-164
Prishtinë, më 23 prill 2014, ora 16:00

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23 PRILL 2014**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari, Xhavit Haliti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, sipas votimit të deputetëve në mbledhjen plenare të 23 prillit 2014, të mbajtur në orën 10.

Në vazhdim, ai procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët për raportin me rekomandime të Komisionit funksional për Legjislacion, për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit Funksional e paraqiti dhe e arsyetoi në Kuvend raportin me rekomandime.

Diskutimi i deputetit Arben Gashi është dhënë i plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputetja Albulena Haxhiu.
Diskutimi i deputetes Albulena Haxhiu është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari më pas i hodhi në votim amendamentet, veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, dhe 7.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 78,
Kundër ----- 10,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Ligji nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.
2. Ligji i dërgohet për shpallje Presidentes së Republikës së Kosovës.

* * *

Kryetari mbylli punimet në orën 16:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesmbajtës:

Selman Ymeri, zyrtar i lartë ligjor